

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI



PUNIM DIPLOME - MASTER

Ndikimi i shpenzimeve të qeverisë mbi rritjen ekonomike në Kosovë

Kandidate:

BSc. Arjeta Krasniqi

Mentore:

Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra

Prishtinë, 2021

Deklaratë

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim me titull “Ndikimi i shpenzimeve të qeverisë mbi rritjen ekonomike në Kosovë“ është punuar nga unë dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara sipas rregullave të caktuara për një punim të mirëfilltë shkencor.

*Ky punim i dedikohet - Familjes sime
Me respekt dhe dashuri!*

Arjeta

Falënderime

Falënderimi i takon Zotit për shëndetin, vullnetin dhe për çdo mirësi që më dhuroj që të arrij sukses dhe të përmbush ëndrrën time.

Falënderim të veçantë për prindërit, që më mbështetën dhe më përkrahën në vendimet e mia dhe në çdo hap të jetës sime, jam falënderuese tërë jetën ndaj tyre dhe shpresoj që do të arrij të i bëj krenar dhe mëtutje.

Falënderoj shumë shoqën time të zemrës Njomza Ahmeti, me të cilën kemi qenë gjithmonë së bashku gjatë tërë këtij rrugëtimi. Me pozitivitet dhe mbështetjen reciproke ndaj njëra-tjetrës kemi arritur të kalojmë çdo sfidë, është ajo e cila më ka qëndruar gjithmonë pranë duke më dhënë motivim, nuk kanë thënë kot “Nuk ka dhuratë më të vlefshme për njeriun se sa sinqeriteti i palëkundur i një miku/e”.

Poashtu falënderoj përzemërsisht Leutrim Haxhiaj, shokun tim më të mirë i cili më inkurajoi dhe më ka dhënë gjithmonë vëmendje, mbështetje dhe përkushtimin e tij.

Për finalizimin e punimit e falënderoj shumë mentorën e temës, Prof. Asoc. Dr. Jehona Shkodra, e cila me gatishmërinë në dhënien e këshillave dhe sugjerimeve më ka ofruar mbështetje të pakursyer profesionale.

Përmbajtja

Lista e tabelave	vi
Lista e figurave	vii
Abstrakti	1
Abstract	2
KAPITULLI I: HYRJE	3
1.1. Identifikimi i problemit dhe qëllimi i hulumtimit	4
1.2. Objektivat dhe hipotezat	5
KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS	6
KAPITULLI III: METODOLOGJIA DHE METODAT E PUNIMIT	9
KAPITULLI IV: ANALIZA E REZULTATEVE	10
4.1. Kosova	10
4.2. Shqipëria	18
4.3. Maqedonia.....	23
4.4. Mali i Zi	28
4.5. Serbia.....	32
4.6. Bosnja	37
4.7. Krahasimi i shpenzimeve për shtetet në hulumtim.....	42
KAPITULLI V: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	43
Referencat.....	45

Lista e tabelave

Tabela 1: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare (Kosovë).....	14
Tabela 2: Korelacioni mes GDP dhe shpenzimeve qeveritare.....	15
Tabela 3: Analiza e regresionit	15
Tabela 4: Rëndësia e modelit ekonometrik	16
Tabela 5: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare.....	17
Tabela 6: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare në Shqipëri.....	19
Tabela 7: Korelacioni mes BPV dhe shpenzimeve qeveritare (Shqipëri)	20
Tabela 8: Analiza e regresionit (Shqipëri).....	21
Tabela 9: Rëndësia e modelit ekonometrik (Shqipëri)	21
Tabela 10: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare në Shqipëri	22
Tabela 11: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare në Maqedoni	24
Tabela 12: Analiza e korelacionit (Maqedoni)	25
Tabela 13: Analiza e regresionit (Maqedoni)	25
Tabela 14: Rëndësia e modelit ekonometrik (Maqedoni).....	26
Tabela 15: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Maqedoni).....	27
Tabela 16: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare (Mali i Zi)	29
Tabela 17: Analiza e korelacionit (Mali i Zi)	30
Tabela 18: Analiza e regresionit (Mali i Zi)	30
Tabela 19: Rëndësia e modelit ekonometrik (Mali i Zi)	31
Tabela 20: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Mali i Zi).....	31
Tabela 21: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare në Serbi.....	33
Tabela 22: Analiza e korelacionit (Serbia)	34
Tabela 23: Analiza e regresionit (Serbi).....	35
Tabela 24: Rëndësia e modelit ekonometrik (Serbi)	35
Tabela 25: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Serbi)	36
Tabela 26: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare (Bosnjë).....	38
Tabela 27: Analiza e korelacionit (Bosnjë)	39
Tabela 28: Analiza e regresionit (Bosnjë)	40
Tabela 29: Rëndësia e modelit ekonometrik (Bosnjë)	40
Tabela 30: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Bosnjë).....	41
Tabela 31: Krahasimi i përgjithshëm i shpenzimeve për të gjitha shtetet e përfshira në hulumtim...42	

Lista e figurave

Figura 1: Shpenzimet për paga dhe mëditje 2002-2020	12
Figura 2: Shpenzimet për mallra dhe shërbime 2002-2020	12
Figura 3: Shpenzimet për subvencione 2002-2020	13
Figura 4: Shpenzimet për transfere sociale 2002-2020	13
Figura 5: Shpenzime kapitale 2002-2020	14
Figura 6: Shpenzimet qeveritare në Shqipëri gjatë periudhës 2002-2020	19
Figura 7: Shpenzimet qeveritare në Maqedoni gjatë periudhës 2002-2020	24
Figura 8: Shpenzimet qeveritare në Malin e Zi gjatë periudhës 2002-2020	29
Figura 9: Shpenzimet qeveritare në Serbi gjatë periudhës 2002-2020	33
Figura 10: Shpenzimet qeveritare në Bosnjë gjatë periudhës 2002-2020	38

Abstrakti

Shpenzimet qeveritare mbi rritjen ekonomike të një vendi, janë një indikator i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe kuptim i faktorëve që ndikojnë në të. Qëllimi i këtij studimi është të analizojmë, të matim rëndësinë dhe masën e ndikimit të shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike në Kosovë, poashtu duke krahasuar variablat (faktorët) me disa shtete të rajonit përreth duke përfshirë: Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedonin, Bosnjën dhe Serbinë për periudhën 2002-2020. Sipas hulumtimeve në literaturë dhe analizës nga të dhënat e mbledhura do të arrijmë me disa rezultate konkrete, përmes modelit të regresionit, DW Testit dhe për multikolonaritetin midis variablave përdoret testi VIF.

Rezultatet tregojnë se shpenzimet qeveritare mund të ndikojnë në rritje ekonomike, megjithëse klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë në disa kategori, tregon që disa prej tyre ndikojnë pozitivisht në rritje ekonomike ndërsa disa në periudha afatagjata nuk kontribuojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike, të njëjtën gjendje e kemi edhe tek shtetet rajonale të përfshira në hulumtim.

Fjalë kyçe: Shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, rritja ekonomike, politika fiskale.

Abstract

Government spending on a country's economic growth is an important indicator of sustainable economic development and an understanding of the factors that affect it. The purpose of this study is to analyze, measure the importance and extent of the impact of government spending on economic growth in Kosovo, also comparing the variables (factors) with several countries in the around region including: Albania, Montenegro, Macedonia, Bosnia and Serbia for the period 2002-2020. According to research in the literature and analysis from the collected data we will achieve some concrete results, through the regression model, the DW Test and for multicollinearity between variables the VIF test is used.

The results show that government spending can affect economic growth, although the classification of government spending into several categories shows that some of them positively affect economic growth while some in the long run don't contribute significantly to economic growth, we have the same situation also to the regional states involved in the research.

Keywords: General government spending, economic growth, fiscal policy.

KAPITULLI I: HYRJE

Në përgjithësi, zhvillimi ekonomik konsiderohet si transformimi strukturor i një ekonomie duke përdorur teknologjinë më të mekanizuar dhe të përditësuar për të rritur produktivitetin e punës, punësimin, të ardhurat dhe standardin e jetesës së popullsisë. Zhvillimi ekonomik duhet të shoqërohet me përmirësime në infrastrukturë, si dhe faktorë social, politikë dhe institucional për të lehtësuar transformimin e ekonomisë (Panth, 2020).

Të hyrat (të ardhurat) publike janë të gjitha të ardhurat e krijuara nga pagesat e detyrueshme të tatimpaguesve, personave juridik dhe fizik që përdorin të mirat e caktuara publike ose shërbimin publik, si dhe të gjitha të ardhurat tjera të realizuara nga përfituesit e buxhetit (M.F, 2019).

Ndërsa Bruto Produkti Vendor (BPV) është një tregues ekonomik që paraqet vlerën me çmimet e tregut të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një shteti në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit) (MF, 2017).

Situata ekonomike paraqet një çështje të një interesi të madh dhe është në fokus të politik-bërjes në mbarë botën sot. Përcaktimi i zhvillimit ekonomik, nënkupton se çfarë politika dhe drejtime ndjek një shtet drejtë arritjes së zhvillimit dhe se çfarë mentaliteti të zhvillimit kanë arritur. Zhvillimi ekonomik është proces, përmes të cilit të ardhurat kombëtare rriten përgjatë një periudhe të gjatë (Lani, 2013).

Zhvillimet makroekonomike dhe projeksionet janë një ndër treguesit kryesor gjatë krijimit të buxhetit. Për shembull, lëvizja e bruto prodhimit vendor (BPV-së) është e lidhur ngushtë me lëvizjen e tatimeve dhe të ardhurat buxhetore. Nëse rritet BPV-ja, kjo do të thotë se shpejtohet aktiviteti ekonomik, që mëtutje reflektohet përmes fluksit të të ardhurave tatimore (shembull, të ardhura më të mëdha buxhetore nga TVSH-ja për shkak të rritjes së qarkullimit në ekonomi apo të ardhura më të mëdha nga tatimi mbi fitimin për shkak të aktivitetit më të madh të ndërmarjeve). Ose, nëse zvogëlohet papunësia, kjo nënkupton rritje në punësim, që përsëri reflektohet përmes të ardhurave më të mëdha nga tatimi personal në buxhet. Nga ana tjetër, gjatë rritjes së papunësisë, rriten shpenzimet sociale në buxhet (MFRM, 2018).

1.1. Identifikimi i problemit dhe qëllimi i hulumtimit

Zhvillimi ekonomik për çdo vend është shumë i rëndësishëm pasi që ndikon në avancimin e shtetit dhe gjenerimin e të ardhurave për të gjithë, andaj në këtë aspekt edhe vendimet e qeverisë për ndarjen buxhetore janë po aq të rëndësishme pasi që ndikojnë në mënyrë direkte ose indirekte në rritjen ekonomike.

Qëllimi i hulumtimit është që të vlerësohen parametrat e dhënë, në mënyrë statistikore dhe të vërehet rëndësia e tyre, përkatësisht pasi që qeveria bën shpërndarjen buxhetore për sektorët e caktuar, ne dëshirojmë të dimë se cilat nga ato shpenzime kanë më shumë ndikim në rritjen e bruto produktit vendor dhe çfarë masa duhet ndërmarr në qoftë se ky ndikim është i vogël në krahasim me shpenzimet që bëhen.

Pas zhvillimit të politikave adekuate nga institucionet vendimmarrëse është parë e arsyeshme të bëhet edhe një lloj hulumtimi i këtillë për të parë nëse vërtet këto politika kanë pasur sukses në përmirësimin e zhvillimit ekonomik të vendit.

Fokusi i këtij punimi do jetë që përmes modelit ekonometrik të shihet sa kanë ndikuar shpenzimet rrjedhëse dhe kapitale drejtë rritjes ekonomike të vendeve të përfshira në hulumtim për një periudhë nëntëmbëdhjet (19) vjeqare. Testimi i këtij modeli do të mundësoj identifikimin e përparësive dhe mangësive në ndarjen e buxhetit për shpenzimet qeveritare që do të ndikojnë në rritje të produktit vendor.

1.2. Objektivat dhe hipotezat

🚦 Objektivi i përgjithshëm:

- Ndikimi që kanë shpenzimet qeveritare mbi rritjen ekonomike

🚦 Objektivat specifike:

- Analizimi i aspektit ekonomik;
- Analizimi i ndikimit të situatave kur ka pasur krizë ekonomike brenda vendit në shpërndarjen e shpenzimeve qeveritare;
- Lidhshmëria dhe ndikimi mes këtyre variablave;
- Përcaktimi nëse shpenzimet qeveritare kanë ndryshueshmëri të ndikimit në rritje ekonomike në periudha afatgjata.

🚦 Disa nga pyetjet hulumtuese:

- Sa ka ndryshuar ndër vite ndarja buxhetore për shpenzimet qeveritare?
- Sa i rëndësishëm është planifikimi buxhetor në rritjen ekonomike?
- Cilat janë politikat që duhet të shqyrtohen për të realizuar apo përmbushur qëllimet që të arrihet një stabilitet në zhvillimin ekonomik?
- A ka dallime të mëdha mes shteteve të përfshira në hulumtim sa i përket ndikimit të shpenzimeve qeveritare në GDP?

Hipotezat:

- 1) Shpenzimet qeveritare ndikojnë në zhvillim ekonomik të një vendi.
- 2) Shpenzimet qeveritare rrisin mirëqenien e popullsisë.
- 3) Shpenzimet qeveritare s'përforcojnë lidhjen pozitive me GDP në periudha afatgjata.

KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS

Për sa i përket rolit dhe ndikimit të shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike të një vendi ka shumë shkrime dhe raporte nga shumë autorë. Në këtë pjesë do të tregojmë disa nga këndvështrimet e disa autorëve të ndryshëm lidhur me këtë tematikë.

Shpenzimet qeveritare mbetën një instrument i rëndësishëm i përdorur në procesin e zhvillimit. Ato luajnë një rol kryesor në funksionimin e çdo ekonomie në pothuajse të gjitha fazat e rritjes dhe zhvillimit. Shumica e vendeve në zhvillim dhe ato të zhvilluara sot përdorin shpenzimet publike për të përmirësuar shpërndarjen e të ardhurave, për të drejtuar shpërndarjen e burimeve në zonat e dëshiruara dhe për të ndikuar në përbërjen e të ardhurave kombëtare (Chandana Aluthge, 2021).

Shpenzimet qeveritare identifikohen nga ekonomistët si një mënyrë për zvogëlimin ose zgjerimin e ekonomisë së një kombi. Rritja e shpenzimeve qeveritare nga ana tjetër do të zgjerojë ekonominë përmes rritjes së aktiviteteve ekonomike, ndërsa do të ulë kontratat e shpenzimeve të qeverisë me ekonominë duke zvogëluar hendekun inflacionist, i cili gjithashtu është i aftë të zvogëlojë aktivitetet ose prodhimin ekonomik (Ashiru Ibrahim, 2019).

Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike varet nga ajo sa qeveria harxhon para dhe si mekanizmi institucional menaxhon shpenzimet. Një punim që është zhvilluar në Indi është përdorur një analizë e thjeshtë regresioni në model për të përcaktuar marrëdhëniet midis shpenzimeve të qeverisë së përgjithshme dhe shkallës së rritjes së BPV-së. Nga rezultatet që janë fituar modeli tregon se vlera katrore R është 83%, do të thotë se 83% e ndryshimit në ritmin e rritjes së BPV-së shpjegohet nga të gjithë variablat e pavarura, të cilat janë shpenzimet e përgjithshme të qeverisë, koeficienti i periudhës së reformës, koeficienti i periudhës së krizës dhe niveli i rritjes së investimeve të huaja direkte (S. V Seshaiyah, 2018).

Në Nepal është shqyrtuar efekti i një komponenti të ndryshëm të shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike, rezultati empirik tregon se ekziston një lidhje pozitive midis rritjes ekonomike si variabël i varur dhe faktorët si sektori bujqësor, jo-bujqësor, industria dhe shërbimi. Ndërsa, shpenzimet totale aktuale dhe ato rrjedhëse dhe inflacioni janë të lidhura negativisht me rritjen ekonomike (Gupta, 2018).

Nivelet e larta të shpenzimeve qeveritare kanë mundësi të rrisin punësimin, përfitimin dhe investimin në kërkesën e përgjithshme. Kështu, shpenzimet qeveritare, mund të kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike (Gupta, 2018).

Ka edhe nga ata që gjetën një mendim të mesëm ku shpenzimet e qeverisë supozohen të kenë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike deri në një optimale të caktuar pragu, mbi të cilin ndikimi i shpenzimeve të qeverisë në rritjen ekonomike kthehet negativ (Sheilla Nyasha, 2019).

Por disa autorë tregojnë se shpenzimet e përgjithshme qeveritare nxisin rritje ekonomike, por rritja ekonomike nuk ndikon që shpenzimet e qeverisë të rriten. Prandaj, ekziston një lidhje e njëanshme midis shpenzimeve qeveritare dhe rritjes ekonomike (Jiranyakul, 2007).

Sipas mendimit Rikardian, efekti i shpenzimeve qeveritare, pavarësisht nëse financohet nga borxhi i qeverisë apo të ardhurat nga taksat, në rritjen ekonomike është neutral. Me fjalë të tjera, kjo marrëdhënie midis shpenzimeve qeveritare dhe rritjes ekonomike nuk ekziston. Arsyeja kryesore që qëndron pas këtij efekti neutral të shpenzimeve të qeverisë për rritjen ekonomike, është pritjet e konsumatorit për rritjen e taksave në të ardhmen. Nëse konsumatorët presin rritje të taksave në të ardhmen, ata do të rrisin kursimet e tyre duke zvogëluar konsumin aktual, i cili nga ana tjetër neutralizon mekanizmin e ndikimit të shpenzimeve qeveritare (Mohammed Alqadi, 2019).

Ligji i Wagner-it ka një mendim tjetër që nuk pajtohet me Rikardian, Wagner argumenton se ekziston një marrëdhënie midis shpenzimit të qeverisë dhe rritjes ekonomike, por ndikimi shkon nga rritja ekonomike në shpenzimet qeveritare. Me fjalë të tjera, Ligji i Wagner supozon se rritja e shpenzimeve qeveritare është rezultat i rritjes ekonomike (Mohammed Alqadi, 2019).

Disa studime empirike kanë përdorur hipotezën e Ligjit Wagner për të vendosur marrëdhëniet midis rritjes së shpenzimeve publike dhe rritjes së BPV-së, ndërsa studime të tjera kanë konstatuar se Ligji i Wagner nuk ka efekt në të gjitha vendet. Për shembull, Ram (1986) testoi Ligjin e Wagner-it për 63 vende dhe gjeti rezultate të kufizuara. Konstatoi që Ligji i Wagner-it mbështetet në strukturën e ekonomisë për vendet e pasura, por jo edhe për vendet e varfëra (Roaa Alrazyeg, 2019).

Andaj në bazë të kësaj çështje themi se supozimet mund të ndahen në gjashtë grupe: (1) ndikimi neutral i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike (Rikardian), (2) ndikimi rrjedh nga rritja ekonomike në shpenzimet qeveritare (Ligji Wagner-it), (3) ndikimi pozitiv i shpenzimeve të qeverisë në rritjen ekonomike (Shkolla Keynesians), (4) ndikimi negativ i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike (Shkolla Neo-klasike), (5) ndikimi pozitiv i shpenzimeve të qeverisë në rritje ekonomike, por nën kushte (Shkolla e Barro) dhe (6) ndikimi jolinear i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike (Mohammed Alqadi, 2019).

Për më tepër, shpenzimet qeveritare gjithashtu mund të kontribuojnë në mënyrë indirekte në rritjen ekonomike duke rritur produktivitetin marginal të faktorëve të qeverisë dhe faktorët e furnizimit të prodhimit. Shpenzimet qeveritare për hulumtime dhe zhvillim, për shembull, japin produktivitet më të lartë në bashkëveprimin midis faktorëve fizikë dhe kapitalit njerëzor. Në mënyrë të ngjashme, përbërësit e tjerë të shpenzimeve qeveritare të lidhura me zbatimin e të drejtave pronësore dhe mirëmbajtjen e rendit publik mund të ushtrojnë një efekt indirekt pozitiv në rritje duke kontribuar në përdorimin më të mirë të kapitalit ekzistues dhe asetëve të punës (Maingi, 2017).

Efektet e programeve të shpenzimeve qeveritare në ekonomi varen nga specifikat e politikës, përfshirë kohën e shpalljes së politikës, kohën e shpenzimeve dhe detajet e zbatimit të politikës (Jaeger Nelson, 2021).

KAPITULLI III: METODOLOGJIA DHE METODAT E PUNIMIT

Ky punim bazohet në të dhënat sekondare që janë realizuar në dy forma: Qasjen kuantitative (sasiore) dhe qasjen kualitative, do të thotë së pari është shfrytëzuar literatura për të mbledhur të dhënat statistikore përmes raporteve të institucioneve shtetërore (Institucionet financiare, Agjensionet statistikore, Bankës qendrore etj) për të gjitha shtetet e përfshira në hulumtim që i përkasin periudhës 2002-2020 dhe pastaj shfrytëzimin e literaturës dhe raporteve në aspektin kuantitativ duke përfshirë hulumtimet më të reja që janë publikuar në kohën e fundit.

Pasi kemi bërë mbledhjen e të dhënave i kemi paraqitur në një databazë, ku kemi vendosur bruto produktin vendor, shpenzimet rrjedhëse (pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet si dhe transferet sociale) dhe shpenzimet kapitale.

Të dhënat e mbledhura në excel i kemi vendosur në Minitab, që është një program statistikor i cili përdoret për analiza ekonometrike. Modelin ekonometrik të cilin do ta përdorim në këtë studim përpiket të shpjegoj lidhjen midis variablave të pavarura dhe variablit të varur. Për të vlerësuar lidhjen e shpenzimeve qeveritare dhe rritjes ekonomike do të përdorim modelin e regresionit, DW Testit dhe për multikolonaritetin midis variablave do të përdorim VIF testin. Si variabël të varur do të përdorim rritjen ekonomike, kurse variabël të pavarur shpenzimet qeveritare në bazë të ekuacionit:

$$Y = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \beta_3 X_3 + \beta_4 X_4 + \beta_5 X_5 + e_i;$$

Y. Rritja ekonomike (BPV)

X₁. Pagat dhe mëditjet

X₂. Mallrat dhe shërbimet

X₃. Subvencionet dhe transfere

X₄. Transfere sociale

X₅. Shpenzime kapitale

Esenca e kësaj metode bazohet nëse faktorët e caktuar kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në performancën e rritjes ekonomike, ndërsa tek pjesa tjetër janë analizuar të dhënat ku kemi bërë përpunimin, vlerësimin, dhe komentimin e tyre, pastaj nga analiza statistikore kemi vlerësuar marrëdhëniet apo lidhjen mes variablave të caktuara.

KAPITULLI IV: ANALIZA E REZULTATEVE

4.1. Kosova

Kosova është një vend i pasur me burime natyrore dhe me potencial për zhvillim ekonomik. Bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, ka konkurrencë të lirë që favorizon hapjen e tregjeve, si e vetmja mundësi për ngritje të qëndrueshme të aftësisë konkurruese. Në vitin 2018, rritja ekonomike ishte 4% sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar. Faktori kryesor që nxit ekonominë janë paratë nga transferet e diasporës (remitancat) të cilat investohen kryesisht në konsum privat dhe blerje të pasurive të patundshme. Në vitin 2019, shkalla e punësimit është 30.1%, shkalla e papunësisë është 25.7% ndërsa shkalla e jo aktivitetit (fuqia punëtore e cila nuk është duke kërkuar punë) është 59.5%. Megjithëse, papunësia aktuale mund të jetë më e ulët për shkak të statistikave të pamjaftueshme që mbulojnë sektorin informal (Nora Hasani, 2020).

Me 29 qershor 2009, Kosova është anëtarësuar në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Kosova ka një politikë fiskale stabile. Baza e të ardhurave tatimore është zgjeruar duke mundësuar rritjen e shpenzimeve qeveritare dhe si kthim i kësaj të mbështesë rritjen ekonomike. Përveç performancës së mirë ekonomike, Kosova ka një politikë monetare stabile. Kosova është një prej vendeve jashtë zonës së BE-së që ka në përdorim valutën e euros, si valutë zyrtare. Përdorimi i euros ka siguruar inflacion të ulët dhe mjedis stabil makroekonomik. Rritja ekonomike gjatë vitit 2019 vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me vitin 2018. Këto vlerësime mbështetën në zhvillimet jo aq të favorshme në sektorin e jashtëm (rënies së eksportit të mallrave dhe shërbimeve, rënies së IHD-ve, përsheptim të rritjes së importit, etj.) si dhe rënies së kredive të reja konsumuese dhe investuese (Nora Hasani, 2020).

Në vitin 2020, situata dhe perspektiva ekonomike në Kosovë ka ndryshuar për shkak të pandemisë Covid-19. Ndikimi në ekonomi i pandemisë dhe masave të ndërmarra nga qeveria kanë bërë që parashikimet fiskale për këtë vit të ndryshojnë krahasuar me projeksionet e buxhetit 2020. Shpenzimet buxhetore në periudhën afatmesme priten të stabilizohen pas pandemisë Covid-19 dhe gradualisht të rikthehen në nivelet e rritjes historike.

Viti 2021 karakterizohet nga një rënie në disa prej kategorive të shpenzimeve kryesisht për shkak të efektit bazë të vitit 2020, kur ka patur një rritje të theksuar në disa kategori si rrjedhojë e masave stimuluese fiskale të qeverisë (MF, 2020).

Pandemia (Covid-19) ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve qeveritare, veçanërisht në lidhje me blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Ka pasur një rritje të dukshme të shpenzimeve për të adresuar nevojat plotësuese dhe mungesat e sistemit të kujdesit shëndetësor në komuna, veçanërisht kërkesa për pajisje mjekësore. Duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e buxheteve lokale janë kryesisht shpenzime në lidhje me pagat dhe mëditjet, ka shumë pak hapësirë për komunat për të adresuar shpenzime shtesë që vijnë nga kontrolli i pandemisë (KLGJ, 2020).

Në mënyrë që të trajtohen sfidat e menjëhershme ekonomike dhe të parandalohet përkeqësimi i mëtejshëm, kërkohet koordinim midis të gjithë palëve, pasi nuk do të jetë e mundur që qeveria të kalojë këtë krizë vetëm e pa bashkëpunim. Kohët sfiduese si kjo thërresin për udhëheqje të fortë e të qëndrueshme në qeveri, biznes dhe në vetë shoqëri (OEAK, 2020).

Qeveria i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton dhe ka në dispozicion. Ajo planifikon se sa nga të hyrat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të shtetit si për shembull, për pagat e të punësuarve në sektorin publik, shpenzime për arsim, shëndetësi, pensione, nxitje të punësimit dhe zbutje të varfërisë, shpenzime kapitale, rritjen e mirëqenies së qytetarëve, zhvillimin e ekonomisë, etj. Buxheti i shtetit planifikohet për një periudhë të caktuar që quhet “vit buxhetor”. Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor (MF, 2020).

Buxheti i Kosovës përgatitet nga Ministria e Financave (MF), në koordinim me organizatat buxhetore, dhe miratohet në fund të vitit nga kuvendi i Kosovës. Buxheti për vitin e ardhshëm përgatitet në vitin aktual përmes një vargu veprimesh të njohura si proces buxhetor. Në kohën kur kuvendi miraton ndarjet buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal, këto ndarje buxhetore bëhen ligj i cili quhet ligji për buxhetin për vitin e caktuar. Ky ligj i buxhetit i miratuar nga kuvendi u ofron organizatave buxhetore autorizim për të shpenzuar apo transferuar fonde publike, deri në kufijtë e caktuar dhe për qëllimet e caktuara sipas ligjit, gjatë një viti të caktuar fiskal (MF, 2020).

Shpenzimet qeveritare mbetën një instrument i rëndësishëm në procesin e zhvillimit. Ai luan një rol kyç në funksionimin e ekonomisë pothuajse në të gjitha fazat e rritjes dhe zhvillimit. Shumica e vendeve në zhvillim dhe të zhvilluara sot përdorin shpenzimet publike për të përmirësuar shpërndarjen e të ardhurave, për të drejtuar shpërndarjen e burimeve në zonat e dëshiruara dhe për të ndikuar në përbërjen e të ardhurave kombëtare (Chandana Aluthge, 2021).

Të dhënat për shpenzimet e qeverisë së Kosovës gjatë periudhës 2002-2020 i kemi paraqitur në mënyrë grafike si në vijim:




Figura 1: Shpenzimet për paga dhe mëditje 2002-2020




Figura 2: Shpenzimet për mallra dhe shërbime 2002-2020




Figura 3: Shpenzimet për subvencione 2002-2020




Figura 4: Shpenzimet për transfere sociale 2002-2020




Figura 5: Shpenzime kapitale 2002-2020

Analiza e hulumtimit

Tabela 1: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare (Kosovë)

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	19	4712	1529	2420	7056
Pagat dhe mëditjet	19	347.8	211.5	43.0	661.0
Mallra dhe shërbime	19	184.8	51.3	102.0	280.0
Subvencionet	19	341.5	185.9	153.0	868.0
Transfere sociale	19	250.1	171.6	38.4	673.0
Shpenzimet kapitale	19	368.3	205.5	47.0	726.0

Burimi: Kalkulim nga autorja

Analiza e korelacionit

Kjo analizë përdoret për të matur fortësinë e raporteve (korelacionit) në mes të dy variablave. Ajo matet përmes koeficientit të korelacionit (r) që ka vlerat prej -1 deri në 1. Sa më afër vlerës 1 kemi lidhje të fortë ose funksionale në mes variablave, ndërsa sa më afër 0, korelacioni apo lidhja mes variablave është e dobët.

Tabela 2: Korelacioni mes GDP dhe shpenzimeve qeveritare

Correlation:					
	BPV	Pagat/mëditj	Mallra/shërb.	Subvenc.	T.sociale
Paga/ mëditje	0.985				
Mallra/shërbime	0.973	0.963			
Subvencionet	0.838	0.820	0.872		
Transfere sociale	0.907	0.906	0.919	0.927	
Shpenzimet kapitale	0.833	0.824	0.782	0.484	0.650
Cell Contents: Pearson correlation					

Burimi: Kalkulim nga autorja

Të gjitha kategoritë e shpenzimeve qeveritare kanë një lidhje të fortë me zhvillimin ekonomik pasi që rezultatet tregojnë për një vlerë të indeksit përafërsisht 1.

Analiza e regresionit

Në një ekuacion regresioni linear, koeficientët e regresionit paraqesin rritjen në variablin e varur si rezultat i rritjes me një njësi në variablin e pavarur që e shoqëron atë koeficient. Në këtë rast ne kemi analizuar se cili është ndikimi i rritjes së shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike apo variablën e varur.

Tabela 3: Analiza e regresionit

Coefficients						
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value	VIF
Constant	1305	484	(260, 2351)	2.70	0.018	
Paga dhe mëditje	4.05	1.15	(1.56, 6.54)	3.51	0.004	19.21
Mallra dhe shërbime	6.80	5.05	(-4.12, 17.71)	1.35	0.201	21.76
Subvencionet	1.32	1.05	(-0.94, 3.58)	1.26	0.229	12.22
Transfere sociale	-0.53	1.18	(-3.08, 2.02)	-0.45	0.660	13.27
Shpenzimet kapitale	1.154	0.633	(-0.214, 2.522)	1.82	0.091	5.48

Burimi: Kalkulim nga autorja

Për të komentuar rezultatet e fituara nga modeli fillojmë me vlerat e koeficientëve të variablave dhe vlerën e P-së.

Koeficientët tregojnë për dy gjëra: së pari si ndikojnë variablat e pavarura në variablën e varur, kahjen e lidhshmërisë lidhja direkte apo e tërthorët dhe së dyti tregon intensitetin sa ndikon, pra si ndikon dhe sa ndikon variabla në model dhe tek vlera e p-së ose signifikanca tregon a është faktorë që ndikon apo faktorë me peshë më të vogël.

Nga vlerat e p-së kuptojmë se vetëm një nga variablat e pavarura është statistikisht e rëndësishme për model pasi që ka vlerë më të vogël se 0.05, kurse të katër faktorët e tjerë janë të parëndësishëm për modelin pasi vlerat e tyre kalojnë vlerën 0.05.

Vlera e koeficientit për shpenzimet e pagave dhe mëditje është (4.05) që tregon se nëse kemi rritje të pagave për 1 njësi (p.sh një mil. euro) atëherë do të kemi ngritje të bruto produktit për 4.05 mil. euro, gjithashtu të njëjtën lidhje pozitive e kemi edhe me tre faktorët e tjerë në model, nëse kemi rritje të shpenzimeve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve për subvencionet dhe shpenzimet kapitale do të kemi rritje të produktit vendor për vlerat e caktuara të koeficientëve.

Vetëm një raport negativ apo lidhje negative e kemi tek shpenzimet për transfere sociale më të cilën nënkuptojmë që shpenzimet e qeverisë të ndara për këtë sektor nuk kanë ndikim në bruto produktin vendor pasi që me rritjen e këtyre shpenzimeve do të kemi ulje të GDP për 0.53 mijë euro.

Të gjitha këto vlera që kemi analizuar nga koeficientët mund t'i shohim në përqindje se sa kanë kontribuar në rritjen ekonomike andaj së pari analizojmë vlerën e koeficientit të determinacionit (R). Vlera e R-së në këtë model siç shihet edhe në tabelën e mëposhtme është 98.28% që tregon për një model të mirë ekonometrik dhe shpjegon që 98.28 % e ndryshimit në rritjen ekonomike të vendit vjen nga ndryshimi i rritjes së shpenzimeve qeveritare.

Tabela 4: Rëndësia e modelit ekonometrik

Model Summary				
S	R-sq	R-sq(adj)	PRESS	R-sq(pred)
235.948	98.28%	97.62%	2340053	94.44%

Burimi: Kalkulim nga autorja

Përkatesisht kontributi në përqindje për shpenzimet e pagave është 96.94%, për shpenzimet e mallrave është 0.89%, shpenzimet për subvencione 0.00%, transferet sociale 0.01%, shpenzimet kapitale 0.44% ndërsa 1.72 % janë faktorë të tjerë të pashpjegueshëm në model.

Tabela 5: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare

Analysis of Variance							
Source	DF	Seq SS	Contribution	Adj SS	Adj MS	F-Value	P-Value
Regression	5	41384806	98.28%	41384806	8276961	148.68	0.000
Paga dhe mëditje	1	40821366	96.94%	686526	686526	12.33	0.004
Mallra dhe shërbime	1	373178	0.89%	100781	100781	1.81	0.201
Subvencionet	1	839	0.00%	88696	88696	1.59	0.229
Transfere sociale	1	4558	0.01%	11260	11260	0.20	0.660
Shpenzimet kapitale	1	184865	0.44%	184865	184865	3.32	0.091
Error	13	723729	1.72%	723729	55671		
Total	18	42108535	100.00%				

Burimi: Kalkulim nga autorja

Pasi që kemi bërë analizën e këtij modeli për Kosovën dhe kemi kuptuar se çfarë ndikimi dhe rëndësie kanë variablat në rritjen e zhvillimit ekonomik, ne do të krahasojmë këto të dhëna me shtetet e tjera përreth dhe do të arrijmë me një konkluzion të përgjithshëm.

4.2. Shqipëria

Stimulimi i rritjes ekonomike bën pjesë në objektivat më të rëndësishëm të politikave publike. Debatet politike, ekonomike e sociale vazhdojnë të kenë në thelbin e tyre “gjetjen e mjeteve dhe mënyrave për të nxitur rritjen ekonomike si rruga kryesore e zhvillimit ekonomik”. E shprehur si përqindje në raport me BPV, rritja ekonomike paraqitet nga ekonomistët dhe politikanët si “rruga e vetme që të dërgon drejtë progresit social dhe mirëqënies”, si “çelësi i vetëm për krijimin e pasurisë së individëve dhe shteteve”, si “pasuri që, pastaj mund të përdoret për shërbime të ndryshme publike apo të rishpërndahet për ata që kanë nevojë në kuadrin e politikave sociale” (Stine Klapper, 2020).

Shqipëria pësoi dy goditje të njëpasnjëshme me pasoja shkatërruese: një tërmet i fuqishëm në fund të vitit 2019 dhe pandemia globale e Covid-19 në fillim të vitit 2020. Efektet e këtyre goditjeve dominojnë zhvillimet e fundit ekonomike dhe perspektivën afatshkurtër të ekonomisë (WBO, 2020).

Pasi u godit rëndë nga pandemia, ekonomia shqiptare ka nisur të rimëkëmbet në 2021. BPV-ja në vitin 2020 ra me 4% dhe qeveria rriti borxhin publik për të zbutur humbjet ekonomike nëpërmjet rritjes së shpenzimeve (WBG, 2021).

Shpenzimet buxhetore për periudhën 2021-2023 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në procesin e rindërtimit si dhe financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020).




Figura 6: Shpenzimet qeveritare në Shqipëri gjatë periudhës 2002-2020

Tabela 6: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare në Shqipëri

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	19	1207303	336000	622711	1679247
Paga dhe mëditje	19	60977	9247	41908	76962
Mallra dhe shërbime	19	33483	9271	20508	48906
Subvencionet	19	2868	1436	1421	6243
Transfere sociale	19	111519	44334	52457	179364
Shpenzime kapitale	19	63126	18333	31472	95881

Burimi: Kalkulim nga autorja

Tek analiza e korelacionit mund të vërejmë se jo të gjitha kategoritë e shpenzimeve qeveritare kanë lidhje pozitive mes vete, duke filluar nga shpenzimet e subvencioneve shohim se vlera e koeficientit është (-0.895) që tregon për një lidhje të dobët, në këtë rast këto shpenzime nuk ndikojnë shumë në rritjen e produktit vendor, poashtu edhe raporti mes shpenzimeve për subvencionet dhe variablat paga/mëditje dhe mallra/shërbime është lidhje negative që do të thotë se kur kemi rritje të shpenzimeve për subvencione do të kemi ulje të

shpenzimeve për pagat dhe mallrat, i njëjti raport vlen edhe për dy kategoritë e tjera tek kolona e katërt mes subvencioneve dhe transfereve sociale si dhe shpenzimeve kapitale.

Tabela 7: Korelacioni mes BPV dhe shpenzimeve qeveritare (Shqipëri)

Correlation:					
	BPV	Paga/mëd.	Mallra/shërb.	Subvenc.	T.sociale
Paga /mëditje	0.809				
Mallra/shërbime	0.945	0.717			
Subvencionet	-0.895	-0.798	-0.784		
T.sociale	0.973	0.714	0.967	-0.814	
Shp. kapitale	0.668	0.782	0.599	-0.715	0.558
Cell Contents: Pearson correlation					

Burimi: Kalkulim nga autorja

Sa i përket analizës së regresionit, në këtë rast mund të vërejmë se ndryshe nga Kosova, në Shqipëri kemi dy kategori të shpenzimeve qeveritare të cilat nuk kanë ndikim në rritjen e produktit vendor. Me rritjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për një njësi do të kemi ulje të bruto produktit për (-0.65) poashtu edhe për kategorinë e shpenzimeve për subvencione vlen i njëjti raport pasi që kemi lidhje negative në këtë rast rritja për shpenzimet e subvencioneve do të ndikoj në uljen e GDP-së për (-46.1).

Kurse të tre variablat e tjera kanë lidhje pozitive me variablin kryesor, duke filluar nga shpenzimet për paga dhe mëditje me vlerë të koeficientit (3.97) tregon se kur rriten shpenzimet për këtë kategori do të ketë rritje ekonomike për 3.97, kur kemi rritje të shpenzimeve për transferet sociale për një njësi do të kemi rritje ekonomike për 5.50 ndërsa kur qeveria investon në shpenzimet kapitale do të kemi rritje ekonomike për 0.87.

Nga vlerat e p-së kuptojmë që për këtë model kemi dy faktorë të rëndësishëm statistikisht (transferet sociale dhe shpenzimet kapitale) pasi kanë vlerë më të vogël se 0.05.

Tabela 8: Analiza e regresionit (Shqipëri)

Coefficients						
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value	VIF
Constant	450888	166161	(91919, 809856)	2.71	0.018	
Pagat dhe mëditjet	3.97	2.42	(-1.25, 9.19)	1.64	0.125	3.93
Mallra/shërbime	-0.65	5.08	(-11.62, 10.32)	-0.13	0.901	17.40
Subvencionet	-46.1	17.1	(-83.1, -9.1)	-2.69	0.018	4.74
Transfere sociale	5.50	1.14	(3.04, 7.95)	4.83	0.000	19.95
Shpenzime kapitale	0.87	1.08	(-1.47, 3.22)	0.81	0.434	3.10

Burimi: Kalkulim nga autorja

Vlera e koeficientit të determinacionit për këtë model është 98.53% që tregon për një model të mirë ekonometrik dhe shpjegon që 98.53% e ndryshimit në rritjen ekonomike vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare.

Tabela 9: Rëndësia e modelit ekonometrik (Shqipëri)

Model Summary				
S	R-sq	R-sq(adj)	PRESS	R-sq(pred)
47880.4	98.53%	97.97%	6.21931E+10	96.94%

Burimi: Kalkulim nga autorja

Kurse kontributi në përqindje për secilën kategori është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 10: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare në Shqipëri

Analysis of Variance					
Source	DF	Seq SS	Contribution	Adj SS	Adj MS
Regression	5	2.00233E+12	98.53%	2.00233E+12	4.00465E+11
Pagat/ mëditjet	1	1.33031E+12	65.46%	6179331357	6179331357
Mallra/shërbime	1	5.55977E+11	27.36%	37222057	37222057
Subvencionet	1	60655273906	2.98%	16630477119	16630477119
Transfere sociale	1	53895147050	2.65%	53577836496	53577836496
Shpenzime kapitale	1	1492754374	0.07%	1492754374	1492754374
Error	13	29802893695	1.47%	29802893695	2292530284
Total	18	2.03213E+12	100.00%		
Source	F-Value	P-Value			
Regression	174.68	0.000			
Pagat dhe mëditjet	2.70	0.125			
Mallra/shërbime	0.02	0.901			
Subvencionet	7.25	0.018			
Transfere sociale	23.37	0.000			
Shpenzime kapitale	0.65	0.434			
Error					
Total					

Burimi: Kalkulim nga autorja

4.3. Maqedonia

Buxheti i Republikës së Maqedonisë pasqyron lëvizjet e pritshme fiskale, të ardhurat publike për financimin e politikave dhe objektivave prioritare, me qëllim të ruajtjes së rritjes ekonomike dhe mbrojtjes sociale (ESHR, 2019).

Në vitin 2020, rritja e përshpejtuar ekonomike e Republikës së Maqedonisë dhe perspektiva pozitive u ndalën papritur nga pandemia COVID-19. Numri i rasteve u rrit me shpejtësi, si rezultat, BPV pësoi rënie me 4.5% në vit. Vetëm konsumi publik kontribuoi pozitivisht në rritje, i nxitur nga blerjet e qeverisë për të mbuluar nevojat e sektorit shëndetësor dhe për të zbatuar masa të konsiderueshme dhe të synuara mirë nga mbështetjet e njëpasnjëshme financiare (EU, 2021).

Shpenzimet aktuale në Maqedoninë e Veriut karakterizohen nga shpenzime të larta dhe në rritje për mbrojtjen sociale, gjë që kërkon monitorim. Shpenzimet e vendit për mbrojtjen sociale janë ndër më të lartët në rajon. Ajo përbën 45% të shpenzimeve aktuale të qeverisë së përgjithshme dhe përveç shpenzimeve të interesit dhe subvencioneve, është i vetmi shpenzim periodik prandaj kategoria e buxhetit është rritur (WB, 2019).

Të gjitha kategoritë e tjera të shpenzimeve - pagat, mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet kapitale - janë relativisht të ulëta ose në të njëjtin nivel me shtetet rajonale. Fatura e pagave të qeverisë është e dyta më e ulëta në rajon, në përputhje me tendencat rajonale, ajo ka rënë në vitet e fundit. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë gjithashtu më të ulëta në nivel rajonal, duke qenë se kjo kategori përfshin mirëmbajtjen dhe riparimet, shpenzimet e ulëta të vendit nuk mund të bëhet sigurim i mjaftueshëm i ndërtesave dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës si dhe të aseteve publike, si rrugët, shkollat dhe spitalet. Nëse nuk adresohet, kjo mund të sjellë përfundimisht kosto shtesë të konsiderueshme për qeverinë dhe përdoruesit e shërbimeve (WB, 2019).

Si një vend i vogël në zhvillim, Maqedonia e Veriut lufton me burime të kufizuara financiare. Me borxhin e lartë publik ekzistues, mundësitë për masa urgjente ekonomike që synojnë të mbështesin kompanitë janë shumë të kufizuara. Të ardhurat e buxhetit të shtetit nuk do të jenë të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat në anën e shpenzimeve dhe kjo situatë dërgon në deficit më të madh buxhetor se sa ishte planifikuar fillimisht. Për më tepër,

palët e interesuara do të përmbahen nga blerja dhe investimet, kështu që rritja ekonomike do të jetë negative, ose në rastin më të mirë të mbetet në të njëjtin nivel (EENM, 2020).




Figura 7: Shpenzimet qeveritare në Maqedoni gjatë periudhës 2002-2020

Analiza e hulumtimit

Tabela 11: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare në Maqedoni

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	19	464989	139935	258581	689425
Paga dhe mëditje	19	23954	2921	18337	30615
Mallra dhe shërbime	19	15867	4992	6833	22693
Subvencionet	19	14534	4588	6830	21838
Transfere sociale	19	59306	39028	346	116046
Shpenzime kapitale	19	18382	7658	4687	28871

Burimi: Kalkulim nga autorja

Vlerat e koeficientëve të korelacionit në kolonën e parë tregojnë për një raport pozitiv mes variablave, do të thotë që të gjitha shpenzimet qeveritare kanë lidhje të fortë pozitive me rritjen ekonomike ndërsa raporti mes pagave/mëditjeve dhe subvencioneve është negativ, do të thotë lidhje e dobët që me rritjen e shpenzimeve për paga/mëditje do të kemi ulje të shpenzimeve për subvencionet, i njëjti raport vlen edhe tek kategoria e mallrave/shërbimeve me shpenzimet e subvencioneve, poashtu edhe tek kolona e katërt mes subvencioneve edhe transfereve sociale si dhe shpenzimeve kapitale.

Tabela 12: Analiza e korelacionit (Maqedoni)

Correlation:					
	BPV	Paga/mëditje	Mallra/shërbime	Subvencionet	T.sociale
Paga dhe mëditje	0.890				
Mallra/shërbime	0.664	0.601			
Subvencionet	0.019	-0.014	-0.443		
Transfere sociale	0.960	0.864	0.818	-0.171	
Shpenzime kapitale	0.697	0.628	0.893	-0.458	0.810

Cell Contents: Pearson correlation

Burimi: Kalkulim nga autorja

Në vazhdim kemi paraqitur analizën e regresionit, ku përmes vlerës së koeficientëve do të kuptojmë së cilat nga kategoritë e shpenzimeve qeveritare kanë ndikim në rritjen ekonomike në Maqedoni.

Tabela 13: Analiza e regresionit (Maqedoni)

Coefficients						
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value	VIF
Constant	195801	104262	(-29443, 421044)	1.88	0.083	
Pagat dhe mëditjet	3.83	4.46	(-5.80, 13.46)	0.86	0.405	4.60
Mallrat dhe shërbimet	-8.26	3.10	(-14.96, -1.57)	-2.67	0.019	6.49
Subvencionet	3.44	1.68	(-0.19, 7.07)	2.05	0.061	1.61
Transfere sociale	3.884	0.480	(2.846, 4.922)	8.09	0.000	9.53
Shpenzime kapitale	1.53	1.94	(-2.67, 5.73)	0.79	0.446	6.01

Burimi: Kalkulim nga autorja

Në bazë të rezultateve kuptojmë se në rritjen ekonomike në Maqedoni ndikojnë katër nga pesë kategoritë e shpenzimeve qeveritare që janë gjithsej, që do të thotë se vetëm shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë raport të zhdrejtë apo negativ në zhvillim ekonomik, pra me rritjen e shpenzimeve për mallra/shërbime për një njësi të caktuar do të kemi ulje të GDP-së për (-8.26).

Kur qeveria investon në rritjen e pagave dhe mëditjeve për një njësi të caktuar (p.sh një mil. euro) do të kemi rritje të BPV për 3.83 mil. euro, poashtu edhe te kategoria për subvencione kemi lidhje pozitive, në këtë rast GDP rritet për 3.44.

Të njëjtin raport pozitiv kemi edhe për dy variablat e tjera në model, kur kemi rritje të shpenzimeve për transferet sociale do të kemi rritje të GDP-së për 3.884 ndërsa për shpenzimet kapitale, rritja e GDP-së arrin në 1.53.

Rëndësinë e këtij modeli e kuptojmë nga tabela e mëposhtme, që tregon se vlera e koeficientit të determinimit është $R= 97.55\%$, dhe kjo vlerë sqaron se 97.55% e ndryshimit të zhvillimit ekonomik vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare.

Tabela 14: Rëndësia e modelit ekonometrik (Maqedoni)

Model Summary				
S	R-sq	R-sq(adj)	PRESS	R-sq(pred)
25764.7	97.55%	96.61%	2.47561E+10	92.98%

Burimi: Kalkulim nga autorja

Kurse kontributin në përqindje për secilën kategori të shpenzimeve e kemi paraqitur në tabelën vijuese, ku shohim se kategoria për shpenzimet e pagave dhe mëditjeve kontribuon me 79.15%, mallrat dhe shërbimet 2.64%, subvencionet 2.04%, transferet sociale 13.60%, shpenzimet kapitale 0.12% ndërsa 2.45% janë faktorë të tjerë të pashpjegushëm në model.

Tabela 15: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Maqedoni)

Analysis of Variance					
Source	DF	Seq SS	Contribution	Adj SS	Adj MS
Regression	5	3.43845E+11	97.55%	3.43845E+11	68769011736
Paga dhe mëditje	1	2.78989E+11	79.15%	490936128	490936128
Mallra dhe shërbime	1	9307951114	2.64%	4715859472	4715859472
Subvencionet	1	7194395975	2.04%	2789091931	2789091931
Transfere sociale	1	47943469965	13.60%	43398760044	43398760044
Shpenzime kapitale	1	410182912	0.12%	410182912	410182912
Error	13	8629672275	2.45%	8629672275	663820944
Total	18	3.52475E+11	100.00%		
Source	F-Value	P-Value			
Regression	103.60	0.000			
Paga dhe mëditje	0.74	0.405			
Mallra dhe shërbime	7.10	0.019			
Subvencionet	4.20	0.061			
Transfere sociale	65.38	0.000			
Shpenzime kapitale	0.62	0.446			
Error					
Totale					

Burimi: Kalkulim nga autorja

4.4. Mali i Zi

Pas ritmeve të larta të rritjes dhe trendeve pozitive në ekonomi gjatë vitit të kaluar por edhe pritjeve optimiste për trende të favorshme gjatë vitit 2020, kriza e shkaktuar nga pandemia ndikoi në një rënie të madhe të aktivitetit ekonomik dhe e solli ekonominë malazeze në rënie. Norma negative të rritjes janë shënuar pothuajse në të gjitha segmentet e ekonomisë. Kriza pati ndikimin më të madh në sektorin e shërbimeve, i cili gjeneron kontributin më të madh në rritjen e ekonomisë malazeze. Një numër i madh i kompanive po përballen me vështirësi në të bërit biznes dhe një numër i konsiderueshëm i punëtorëve kanë humbur punën. Për të luftuar efektet e pandemisë, qeveria ka miratuar masa të ndryshme përmes tre paketave të ndihmës financiare (Mirkovic, 2020).

Synimi strategjik i zhvillimit të Malit të Zi i përcaktuar në programin e reformave ekonomike është rritja ekonomike e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse që do të kontribuojë në uljen e hendekut të zhvillimit të vendit në raport me mesataren e BE-së dhe në rritjen e cilësisë së jetës së të gjithë qytetarëve të tij (VCG, 2020).

Qeveria e Malit të Zi do të vazhdoj të zbatoj politikat fiskale dhe masat e reformës strukturore brenda kompetencës së saj me synimin për të kontribuar në arritjen e suficiteve të financave publike nga viti 2020 dhe uljen e niveleve të borxhit publik si të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik dhe arritjen e rritjes të qëndrueshme ekonomike. Njëkohësisht, rëndësi të veçantë kanë masat e politikës ekonomike që synojnë zgjidhjen e problemeve strukturore në ekonomi, pra heqjen e pengesave kryesore për përmirësimin e konkurrencës së vendit dhe rritjen potenciale ekonomike në afat të mesëm dhe afatgjatë. Kjo është aq më tepër sepse Mali i Zi është një ekonomi e vogël në të cilën politika fiskale është një instrument kyç i politikës ekonomike (VCG, 2020).

Ndërsa sa i përket buxhetit në Mal të Zi, ai përkufizohet si një plan financiar i bazuar në një vlerësim vjetor të të ardhurave dhe shpenzimeve që duhet të balancohen. Buxheti duhet të tregoj të gjitha shpenzimet dhe burimet e tyre të financimit, ku buxheti aktual tregon planin e financimit të aktiviteteve të rregullta dhe shpenzimeve periodike, ndërsa buxheti kapital përfshin shpenzimet që mund të zgjasin më shumë se një vit (Dabovic, 2020).




Figura 8: Shpenzimet qeveritare në Malin e Zi gjatë periudhës 2002-2020

Analiza e hulumtimimit

Tabela 16: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare (Mali i Zi)

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	19	3123664632	1056411748	1360353000	4950717000
Paga dhe mëditje	19	308490470	126548997	97675988	502770870
Mallra dhe shërbime	19	89704710	36489726	41817216	168358384
Subvencione	19	22586512	12827164	6072667	49824327
Transfere sociale	19	299424551	242583518	27863035	577660621
Shpenzime kapitale	19	130235592	133838618	10593213	390136160

Burimi: Kalkulim nga autorja

Vlerat e koeficientëve të korelacionit tregojnë se kemi një raport apo lidhje pozitive të fortë mes variablave në model, përkatësisht me rritjen e shpenzimeve qeveritare do të kemi edhe rritje ekonomike, e poashtu edhe raporti mes kategorive të shpenzimeve mes vete është pozitiv, që do të thotë se nëse kemi rritje të shpenzimeve për një kategori të caktuar do të kemi rritje të shpenzimeve edhe për kategoritë tjera të shpenzimeve qeveritare.

Tabela 17: Analiza e korelacionit (Mali i Zi)

Correlation:					
	BPV	Paga/mëd.	Mallra/shërb.	Subvencione	T.sociale
Paga dhe mëditje	0.939				
Mallra/shërbime	0.667	0.703			
Subvencione	0.499	0.494	0.678		
Transfere sociale	0.818	0.927	0.556	0.319	
Shpenzime kapitale	0.854	0.811	0.403	0.283	0.800

Cell Contents: Pearson correlation

Burimi: Kalkulim nga autorja

Nga analiza e regresionit, kemi përfituar rezultatet e mëposhtme, të cilat tregojnë se dy variabla janë në raport të zhdrejtë me bruto produktin vendor, pra kanë lidhje negative (subvencionet dhe transferet sociale). Dhe ne mund të themi se kur qeveria rrit shpenzimet për subvencione do të kemi ulje të GDP-së për (-0.19) e poashtu edhe në rastin e rritjes së shpenzimeve për transferet sociale do të kemi ulje të GDP-së për (-1.988).

Ndërsa në rastin kur kemi rritje për shpenzimet e pagave dhe mëditjeve, raporti është i drejtë pra pozitiv, që tregon se me rritjen e këtyre shpenzimeve rritet edhe BPV për 8.67 edhe tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi lidhje pozitive, me rritjen e shpenzimeve për mallra/shërbime do të kemi rritje të BPV-së për 1.39 gjithashtu raport pozitiv kemi edhe tek kategoria për shpenzimet kapitale, në këtë rast kur qeveria bën shpenzime kapitale më të larta do të ketë edhe GDP më të lartë për 2.82.

Tabela 18: Analiza e regresionit (Mali i Zi)

Coefficients						
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value	VIF
Constant	555169382	292766966	(-77315195, 1187653959)	1.90	0.080	
Paga dhe mëditje	8.67	2.22	(3.88, 13.46)	3.91	0.002	14.88
Mallra dhe shërbime	1.39	3.56	(-6.30, 9.07)	0.39	0.70	33.19
Subvencione	-0.19	8.08	(-17.64, 17.26)	-0.02	0.98	22.03
Transfere sociale	-1.988	0.897	(-3.925, -0.051)	-2.22	0.04	58.95
Shpenzime kapitale	2.82	1.02	(0.62, 5.03)	2.77	0.01	63.52

Burimi: Kalkulim nga autorja

Sa i përket rëndësisë së modelit, vlera e koeficientit të determinimit është $R= 93.84\%$ që tregon se 93.84% e ndryshimit të rritjes ekonomike vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare.

Tabela 19: Rëndësia e modelit ekonometrik (Mali i Zi)

Model Summary				
S	R-sq	R-sq(adj)	PRESS	R-sq(pred)
308513985	93.84%	91.47%	2.41551E+18	87.98%

Burimi: Kalkulim nga autorja

Ndërsa kontributi në përqindje për secilën kategori është si vijon: pagat dhe mëditjet kontribuojnë me 88.15% , mallrat dhe shërbimet 0.01% , subvencionet 0.18% , transferet sociale 1.87% , shpenzimet kapitale 3.63% ndërsa 6.16% janë faktorë të tjerë të pashpjegueshëm në model.

Tabela 20: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Mali i Zi)

Analysis of Variance						
Source	DF	Seq SS	Contribution	Adj SS	Adj MS	F-Value
Regression	5	1.88508E+19	93.84%	1.88508E+19	3.77015E+18	39.61
Paga dhe mëditje	1	1.77076E+19	88.15%	1.45756E+18	1.45756E+18	15.31
Mallra dhe shërbime	1	2.10938E+15	0.01%	1.45026E+16	1.45026E+16	0.15
Subvencione	1	3.53060E+16	0.18%	5.06281E+13	5.06281E+13	0.00
Transfere sociale	1	3.75570E+17	1.87%	4.67742E+17	4.67742E+17	4.91
Shpenzime kapitale	1	7.30152E+17	3.63%	7.30152E+17	7.30152E+17	7.67
Error	13	1.23735E+18	6.16%	1.23735E+18		
Total	18	2.00881E+19	100.00%			
Source	P-Value					
Regression	0.000					
Pagat dhe mëditje	0.002					
Mallra dhe shërbime	0.703					
Subvencione	0.982					
Transfere sociale	0.045					
Shpenzime kapitale	0.016					
Error						
Total						

Burimi: Kalkulim nga autorja

4.5. Serbia

Serbia është një ekonomi në tranzicion me potencial të lartë rritjeje. Serbia ka një themel të fortë të kapitalit njerëzor, kushte të qëndrueshme makroekonomike dhe afërsi me ekonominë e zhvilluara të Evropës Perëndimore. Serbia ka zbatuar konsolidimin fiskal dhe reformat në kuadër të Instrumentit për Koordinimin e Politikave me Fondin Monetar Ndërkombëtar nga viti 2015 deri në vitin 2018, gjë që ka ofruar një bazë solide makroekonomike për rritje. Pandemia e Covid-19 mbylli seksione të mëdha të ekonomisë në vitin 2020, mirëpo tani, ekonomia po rimëkëmbet ngadalë nga rënia dhe parashikimet për rritjen në 2021 variojnë nga 2.9% në 6% (USAID, 2020).

Duke shkuar përpara dhe me kusht që ekonomia të ketë një rimëkëmbje graduale siç është parashikuar aktualisht, planifikimi buxhetor duhet të balancoj mbështetjen për ekonominë me një kthim gradual fiskal.

Hapësira fiskale duhet të drejtohet për investimet publike, të cilat do të jenë kritike për mbështetjen e rritjes, duke kufizuar rritjen e pagave dhe pensioneve në sektorin publik (IMF, 2020).

Identifikimi i rreziqeve fiskale që rrjedhin nga kriza do të jetë i rëndësishëm për mbështetjen e planifikimit të buxhetit dhe projektimin e nevojave për financim. Modernizimi i vazhdueshëm i administratës tatimore do të jetë i nevojshëm për të mbrojtur flukset kryesore të të ardhurave gjatë krizës dhe rimëkëmbjes pasuese (IMF, 2020).

Politika monetare ka qenë lehtësuese dhe janë miratuar masa të përkohshme të jashtëzakonshme për të ndihmuar mbajtjen stabile të sektorit bankar dhe mbështetjen e huamarrjes. Inflacioni mbetet i ulët dhe kursi i këmbimit i qëndrueshëm. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve ekonomike do të jetë çelësi për ruajtjen e stabilitetit makrofinanciar dhe kufizimin e rreziqeve të bilancit (IMF, 2020).




Figura 9: Shpenzimet qeveritare në Serbi gjatë periudhës 2002-2020

Analiza e hulumtimit

Tabela 21: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare në Serbi

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	19	3.41832E+12	1.38781E+12	1.10256E+12	5.46354E+12
Paga dhe mëditje	19	1.58612E+11	70893753873	33489759478	3.07841E+11
Mallra dhe shërbime	19	63651697767	37273139753	13934187233	1.19670E+11
Subvencione	19	73076683003	55087538294	28721703330	2.70178E+11
Transfere sociale	19	83148419707	33627919833	27143093183	1.26188E+11
Shpenzime kapitale	19	57491846496	54874533092	6650438747	1.95937E+11

Burimi: Kalkulim nga autorja

Nga analiza e korelacionit kuptojmë se të gjitha variablat janë në lidhje të fortë pozitive me rritjen ekonomike poashtu edhe në raport në mes vete, pasi vlera e koeficientit të korelacionit i përafrohet 1.

Tabela 22: Analiza e korelacionit (Serbia)

Correlation:					
	BPV	Paga/mëditje	Mallra/shërbime	Subvencione	
T.sociale					
Paga dhe mëditje	0.959				
Mallra dhe shërbime	0.946	0.877			
Subvencione	0.723	0.820	0.678		
Transfere sociale	0.971	0.895	0.943	0.627	
Shpenzime kapitale	0.778	0.847	0.681	0.801	0.634
Cell Contents: Pearson correlation					

Burimi: Kalkulim nga autorja

Rezultatet nga analiza e regresionit tregojnë se kemi një raport negativ në mes rritjes ekonomike dhe subvencioneve ndërsa raportet tjera janë pozitive, në këtë rast me rritjen e njëjës rritet edhe tjetra. Në rastin e rritjes së pagave dhe mëditjeve për një njësi do të kemi rritje të BPV për 5.33, kur kemi rritje të mallrave dhe shërbimeve për një njësi do të kemi rritje të BPV për 4.03 ndërsa tek kategoria për shpenzimet e subvencioneve kemi raportin negativ që do të thotë kur kemi rritje të shpenzimeve për subvencione për një njësi do të kemi ulje të BPV-së për 1.30.

Kurse lidhjen më të fortë në raport me BPV e kemi tek kategoria e shpenzimeve për transfere sociale, në këtë rast me rritjen e shpenzimeve për transfere sociale për një njësi do të kemi rritje të BPV-së për 22.86 ndërsa kur kemi rritje të shpenzimeve kapitale, bruto produkti vendor do të rritet për 4.13.

Tabela 23: Analiza e regresionit (Serbi)

Coefficients					
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value
Constant	2.73285E+11	1.22891E+11	(7795125063,5.38776E+11)	2.22	0.045
Paga dhe mëditje	5.33	2.28	(0.41, 10.25)	2.34	0.036
Mallra dhe shërbime	4.03	3.21	(-2.90, 10.95)	1.26	0.231
Subvencione	-1.30	1.33	(-4.18, 1.58)	-0.98	0.347
Transfere sociale	22.86	4.59	(12.95, 32.76)	4.98	0.000
Shpenzime kapitale	4.13	1.53	(0.83, 7.44)	2.70	0.018
Term	VIF				
Constant					
Paga dhe mëditje	19.64				
Mallra dhe shërbime	10.76				
Subvencione	4.06				
Transfere sociale	17.93				
Shpenzime kapitale	5.31				

Burimi: Kalkulim nga autorja

Koeficienti i determinimit për këtë model është 99.10%, që tregon se 99.10% e ndryshimit të rritjes ekonomike vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare.

Tabela 24: Rëndësia e modelit ekonometrik (Serbi)

Model Summary				
S	R-sq	R-sq(adj)	PRESS	R-sq(pred)
1.54524E+11	99.10%	98.76%	1.02637E+24	97.04%

Burimi: Kalkulim nga autorja

Në këtë përqindje të modelit, pagat dhe mëditjet kontribuojnë me 92.00%, mallrat dhe shërbimet 4.74%, subvencionet 0.64%, transfere sociale 1.22%, shpenzimet kapitale 0.50% ndërsa 0.90% janë faktorë të tjerë të pashpjegueshëm në model.

Tabela 25: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Serbi)

Analysis of Variance						
Source	DF	Seq SS	Contribution	Adj SS	Adj MS	F-Value
Regression	5	3.43578E+25	99.10%	3.43578E+25	6.87157E+24	287.78
Pagat dhe mëditje	1	3.18956E+25	92.00%	1.30953E+23	1.30953E+23	5.48
Mallra dhe shërbime	1	1.64230E+24	4.74%	3.77067E+22	3.77067E+22	1.58
Subvencione	1	2.21219E+23	0.64%	2.27207E+22	2.27207E+22	0.95
Transfere sociale	1	4.24548E+23	1.22%	5.93023E+23	5.93023E+23	24.84
Shpenzime kapitale	1	1.74206E+23	0.50%	1.74206E+23	1.74206E+23	7.30
Error	13	3.10410E+23	0.90%	3.10410E+23	2.38777E+22	
Total	18	3.46682E+25	100.00%			
Source	P-Value					
Regression	0.000					
Paga dhe mëditje	0.036					
Mallra dhe shërbime	0.231					
Subvencione	0.347					
Transfere sociale	0.000					
Shpenzime kapitale	0.018					
Error						
Total						

Burimi: Kalkulim nga autorja

4.6. Bosnja

Bosnja dhe Hercegovina (BiH) është një ekonomi e vogël e hapur me një bazë të larmishme prodhimi dhe eksporti. Shërbimet zënë pjesën më të madhe të ekonomisë boshnjake, duke kontribuar me 55.7% në bruto produktin vendor (BPV) (EC, 2021).

Për sa i përket kriterëve ekonomike, Bosnja dhe Hercegovina ka bërë zhvillim të kufizuar dhe është në një fazë të hershme të krijimit të një ekonomie funksionale. Vendi mori masa për të kundërshtuar efektet negative të pandemisë Covid-19 në ekonomi dhe në tregun e punës. Banka Qendrore ndërmoi masa të rëndësishme për të përmirësuar kapacitetet e saj analitike. Janë marrë disa hapa për të forcuar elasticitetin ndaj goditjeve të sektorit financiar (EC, 2021).

Kjo tregon se kufizimet po pengojnë fluksin e kapitalit dhe inputeve të tjera drejtë sektorëve dhe kompanive më produktive. Këto kufizime përfshijnë një treg të fragmentuar dhe mjedis sfidues biznesi, mungesë aftësish dhe akses të kufizuar në financat. Produktiviteti i ulët i kombinuar me rritjen e lartë të pagave në sektorin publik dhe privat kanë rezultuar në dobësimin e konkurrencës së kostos së punës (OECD, 2021).

Për të krijuar rritje më të fuqishme, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse gjatë dekadës së ardhshme, Bosnja dhe Hercegovina duhet të adresoj sfidat e rëndësishme strukturore që dëmtojnë investimet vendase dhe të huaja, integrimin e zinxhirit të vlerës globale dhe inovacionin. Kjo përfshin reduktimin e fragmentimit të tregut të brendshëm, përmirësimin e klimës së biznesit, forcimin e aftësive të popullsisë dhe reduktimin e mungesave të theksuara në infrastrukturë (OECD, 2021).




Figura 10: Shpenzimet qeveritare në Bosnjë gjatë periudhës 2002-2020

Analiza e hulumtimimit

Tabela 26: Statistikat përshkruese për shpenzimet qeveritare (Bosnjë)

Descriptive Statistics:					
Variable	N	Mean	StDev	Minimum	Maximum
BPV	19	25008647421	7302034030	11651119000	36527050000
Paga dhe mëditje	19	232024772	65115453	144043278	440345790
Mallra dhe shërbime	19	88463957	18045022	53637075	116977112
Subvencionet	19	77773778	35601131	33000000	133414402
Transfere sociale	19	536475337	118926506	407230000	900833730
Shpenzime kapitale	19	573067465	399174458	40854780	1185968580

Burimi: Kalkulim nga autorja

Në këtë analizë të korelacionit kemi fituar disa koeficient me vlera negative që tregon se kemi një raport të zhdrejtë apo negativ, që me rritjen e shpenzimeve për një kategori, kemi ulje të shpenzimeve për kategorinë tjetër. Në kolonën e parë shohim se kemi një lidhje negative mes pagave dhe mëditjeve dhe BPV, që do të thotë se me rritjen e shpenzimeve për paga do të kemi ulje të BPV-së, poashtu edhe për kategoritë tjera vlen i njëjti raport.

Tabela 27: Analiza e korelacionit (Bosnjë)

Correlation:					
	BPV	Paga/med.	Mallra/ sherb.	Subvencionet	T.sociale
Paga dhe mëditje	-0.473				
Mallra dhe shërbime	0.017	0.607			
Subvencionet	0.023	-0.247	-0.327		
Transfere sociale	0.215	-0.005	0.391	0.125	
Shpenzime kapitale	0.873	-0.296	0.001	-0.112	0.006
Cell Contents: Pearson correlation					

Burimi: Kalkulim nga autorja

Sa i përket analizës së regresionit, njësoj si në shtetet tjera edhe në këtë model kemi fituar të dhëna cilësore, në krahasim me Kosovën tek e cila kishim një raport negativ mes BPV dhe transfereve sociale, në këtë model kemi një lidhje negative mes pagave dhe mëditjeve dhe BPV, që do të thotë se me rritjen e shpenzimeve për paga do të kemi ulje të BPV-së për 39.1.

Me rritjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për një njësi do të kemi rritje të bruto produktit vendor për 83.5, me rritjen e shpenzimeve për subvencione do të kemi rritje të BPV për 15.8 ndërsa me rritjen e shpenzimeve për transfere sociale do të kemi rritje të BPV-së për 7.27.

Poashtu edhe shpenzimet të cilat i bën qeveria në kategorinë për shpenzimet kapitale paraqesin një faktorë shtytës për rritje të zhvillimit ekonomik, që do të thotë se me rritjen e këtyre shpenzimeve do të kemi rritje të BPV-së për 14.22.

Tabela 28: Analiza e regresionit (Bosnjë)

Coefficients					
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value
Constant	13405537451	5299624955	(1956393808, 24854681094)	2.53	0.025
Paga dhe mëditje	-39.1	16.0	(-73.7, -4.4)	-2.43	0.030
Mallra dhe shërbime	83.5	63.1	(-52.7, 219.8)	1.32	0.208
Subvencionet	15.8	22.6	(-32.9, 64.5)	0.70	0.495
Transfere sociale	7.27	7.31	(-8.54, 23.07)	0.99	0.339
Shpenzime kapitale	14.22	1.98	(9.94, 18.49)	7.19	0.000
Term	VIF				
Constant					
Paga dhe mëditje	2.11				
Mallra dhe shërbime	2.50				
Subvencionet	1.24				
Transfere sociale	1.46				
Shpenzime kapitale	1.20				

Burimi: Kalkulim nga autorja

Përveç kësaj analize, ne kemi gjetur edhe vlerën për koeficientin e determinimit i cili tregon për rëndësinë e këtij modeli dhe nga tabela e mëposhtme ne mund të shohim se kemi një model të mirë ekonometrik, me vlerë të koeficientit të determinimit $R= 87.35\%$, që tregon se 87.35% e ndryshimit të rritjes ekonomike vjen nga ndryshimi i shpenzimeve qeveritare.

Tabela 29: Rëndësia e modelit ekonometrik (Bosnjë)

Model Summary				
S	R-sq	R-sq(adj)	PRESS	R-sq(pred)
3055703101	87.35%	82.49%	2.07993E+20	78.33%

Burimi: Kalkulim nga autorja

Ndërsa në aspektin e kontributit në përqindje për secilën kategori, kemi fituar këto rezultate: Pagat dhe mëditjet kontribuojnë me 22.35%, mallrat dhe shërbimet 14.61%, subvencionet 0.01%, transfere sociale 0.09%, shpenzime kapitale 50.29% ndërsa 12.65% janë faktorë të tjerë të pashpjegueshëm në model.

Tabela 30: Kontributi në përqindje për shpenzimet qeveritare (Bosnjë)

Analysis of Variance						
Source	DF	Seq SS	Contribution	Adj SS	Adj MS	F-Value
Regression	5	8.38369E+20	87.35%	8.38369E+20	1.67674E+20	17.96
Paga dhe mëditje	1	2.14528E+20	22.35%	5.53071E+19	5.53071E+19	5.92
Mallra dhe shërbime	1	1.40232E+20	14.61%	1.63837E+19	1.63837E+19	1.75
Subvencionet	1	7.94078E+16	0.01%	4.59208E+18	4.59208E+18	0.49
Transfere sociale	1	9.01460E+17	0.09%	9.21477E+18	9.21477E+18	0.99
Shpenzime kapitale	1	4.82629E+20	50.29%	4.82629E+20	4.82629E+20	51.69
Error	13	1.21385E+20	12.65%	1.21385E+20	9.33732E+18	
Total	18	9.59755E+20	100.00%			
Source	P-Value					
Regression	0.000					
Paga dhe mëditje	0.030					
Mallra dhe shërbime	0.208					
Subvencionet	0.495					
Transfere sociale	0.339					
Shpenzime kapitale	0.000					
Error						
Total						

Burimi: Kalkulim nga autorja

Krahasimin e përgjithshëm të shpenzimeve kapitale për të gjitha shtetet e përfshira në hulumtim e kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

4.7. Krahasimi i shpenzimeve për shtetet në hulumtim

Tabela 31: Krahasimi i përgjithshëm i shpenzimeve për të gjitha shtetet e përfshira në hulumtim

Regression Analysis:						
Coefficients						
Term	Coef	SE Coef	95% CI	T-Value	P-Value	VIF
Shp.kapitale- Kosovë	6.202	0.998	(4.097, 8.307)	6.22	0.000	1.00
Shp.kapitale- Shqipëri	12.24	3.31	(5.26, 19.22)	3.70	0.002	1.00
Shp.kapitale- Maqedoni	12.73	3.18	(6.02, 19.44)	4.00	0.001	1.00
Shp.kapitale- Mali i Zi	6.743	0.995	(4.644, 8.843)	6.78	0.000	1.00
Shp.kapitale- Serbi	19.67	3.86	(11.54, 27.80)	5.10	0.000	1.00
Shp.kapitale- Bosnjë	15.96	2.17	(11.39, 20.53)	7.36	0.000	1.00

Burimi: Kalkulim nga autorja

Shohim se të gjitha shpenzimet kapitale kanë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike të vendeve, përkatësisht në Kosovë këto shpenzime ndikojnë në rritje të GDP-së për 6.20 mil.euro, në Shqipëri për 12.24 mil.euro, në Maqedoni 12.73 mil.euro, në Mal të Zi për 6.743 mil. euro, në Serbi për 19.67 mil.euro dhe në Bosnjë këto shpenzime ndikojnë në rritjen e GDP për 15.96 mil.euro dhe nga këto rezultate arrijmë në një konkluzion që këto shpenzime kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

KAPITULLI V: PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Për çdo shtet është i domosdoshëm një shqyrtim në lidhje me ndikimin e faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në rritjen ekonomike. Poashtu, është e nevojshme të kuptohet dhe analizohet roli që luajnë shpenzimet qeveritare në performancën ekonomike të vendit.

Për këtë arsye, qëllimi i punimit ka qenë të hulumtoj marrëdhëniet midis shpenzimeve qeveritare dhe rritjes ekonomike në Kosovë. Fokusi është në ndarjen e kategorive të shpenzimeve qeveritare gjegjësisht në shpenzimet rrjedhëse (pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet, transferet sociale) dhe shpenzimet kapitale, kemi analizuar marrëdhënien afatgjatë midis rritjes ekonomike dhe shpenzimeve qeveritare.

Rezultatet tregojnë se shpenzimet qeveritare mund të ndikojnë në rritje ekonomike, megjithatë, klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë në disa kategori, tregon që disa prej tyre përkatësisht shpenzimet për paga dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe shpenzimet kapitale ndikojnë pozitivisht në rritje ekonomike kurse transferet sociale në periudha afatgjatë nuk kontribuojnë ndjeshëm në rritjen ekonomike.

Po të njëjtën situatë e kemi edhe tek shtetet rajonale të përfshira në studim, konkretisht Shqipëria në krahasim me Kosovën, ka dy variabla apo faktorë që nuk kanë ndikim në rritjen ekonomike, kategoria për shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve si dhe kategoria për subvencionet kanë pasur një lidhje negative me BPV, që tregon se shpenzimet për këto dy kategori nuk kanë një efekt pozitiv sa i përket zhvillimit ekonomik.

Tek Maqedonia rezultatet tregojnë se vetëm shpenzimet për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kanë një lidhje negative me BPV, ndërsa tek Mali i Zi janë shpenzimet për subvencione dhe transfere sociale që kanë një raport të zhdrejtë me rritjen ekonomike.

Ndërsa sa i përket Bosnjës dhe Serbisë, tek të dy këto shtete kemi nga një kategori të shpenzimeve që kanë pasur lidhje negative me rritjen e bruto produktit vendor, përkatësisht në Bosnjë kategoria për shpenzimet e pagave dhe mëditjeve ndërsa në Serbi shpenzimet për subvencione.

Nga këto rezultate ne mund të arrijmë në një konkluzion ku mund të themi se shpenzimet qeveritare në përgjithësi kanë një ndikim shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe se politikat adekuate do të përmirësonin edhe më tutje efektin e tyre në rritjen ekonomike.

Në bazë të këtyre rezultateve shohim se janë vërtetuar të gjitha hipotezat të cilat i kemi parashtruar në hulumtim, konkretisht hipoteza që këto shpenzimet ndikojnë në zhvillim ekonomik të vendit, rrisin mirëqenien e popullsisë si dhe në rastet e caktuara ndikimi i tyre në periudha afatgjata mund të ndryshoj.

Ndërsa duke pasur parasysh marrëdhënien negative midis shpenzimeve të qeverisë me disa nga kategoritë e caktuara (Kosovë - shpenzimet për transferet sociale, Shqipëri - shpenzimet për mallra dhe subvencione, Maqedoni - shpenzimet për mallra dhe shërbime, Mali i Zi - shpenzimet për subvencione dhe transfere sociale dhe Bosnjë - shpenzimet për pagat dhe mëditjet) qeveria duhet të jetë e kujdesshme në menaxhimin e këtyre shpenzimeve, pasi që mund të kenë ndikim në rënie ekonomike.

Për më tepër, politika fiskale mund të përdoret si instrument makroekonomik për stabilitetin ekonomik. Prandaj sugjerohet përdorimi i shpenzimeve në një mënyrë më të mirë në arritjen e objektivave.

Referencat

- Ashiru Ibrahim, I. E. (2019). *Impact of Public Capital Expenditure on Economic Growth in Nigeria*. Nigeria: Department of Economics, IBB University Lapai, Niger State, Nigeria.
- Chandana Aluthge, A. J. (2021). *Impact of government expenditure on economic growth in Nigeria 1970-2019*. Nigeria: The Central Bank of Nigeria.
- Dabovic, M. (2020). *Sistem upravljanja javnom potrosnjom prirucnik*. Podgorica: Nacionalna biblioteka Crne Gore, Cetinje.
- EC. (2021). *Key findings of the 2021 report on Bosnia and Herzegovina*. Strasbourg: European Commission.
- EENM. (2020). *Ndikimi i Covid-19 në sistemin ZhaP/ATP në Maqedoni dhe projektin E4E@MK*. Shkup: Education for Employment in North Macedonia.
- ESHR. (2019). *Raporti vjetor për revizionet e kryera dhe punën e entit shtetëror për revizion për vitin 2019*. Shkup: Enti shtetëror i revizionit.
- EU. (2021). *Commission staff working document - economic reform programme of north Macedonia (2021-2023) commission assessment*. Brussels: European Commission.
- Gupta, R. (2018). *The impact of government expenditure on economic growth in Nepal*. Nepal: Quest International University.
- IMF. (2020). *Republic of Serbia: Fourth review under the policy coordination instrument- press release and staff report*. Washington: International Monetary Fund.
- Jaeger Nelson, K. P. (2021). *The Economic Effects of Financing a Large and Permanent Increase in Government Spending*. Washington: Congressional Budget Office.
- Jiranyakul, K. (2007). *The relation between government expenditures and economic growth in Thailand*. Thailand: Munich personal repee archive.
- Kapidzic, D. (2019). *Bosnia and Herzegovina*. Swedish International Centre for Local Democracy.
- KLGI, K. L. (2020). *Effect of Covid-19 Pandemic in Kosovo, Outlook of municipal budgets*. Pristina: Friedrich Ebert Stiftung.

- Lani, L. (2013). *Konceptet bazë të zhvillimit ekonomik*. Pejë, Kosovë: Kolegji Evropian Dukagjini, Fakulteti Ekonomik.
- M.F. (2019). *Informator për qytetarë - Buxheti i Republikës së Kosovës*. Prishtinë: Ministria e Financave.
- Maingi, J. N. (2017). *The impact of government expenditure on Economic growth in Kenya: 1963-2008*. Kenya: Advances in economics and business.
- MF. (2017). *Informator për qytetarë*. Prishtinë: Ministrisë së Financave - Departamenti i Buxhetit.
- MF. (2020). *Informator për qytetarë, Buxheti i Republikës së Kosovës - 2020 i rishikuar*. Prishtinë: Ministria e financave.
- MF. (2020). *Medium Term Expenditure Framework 2021-2023*. Pristina: Ministry of Finance.
- MFRM. (2018). *Buxheti i qytetarëve*. Maqedoni: Republika e Maqedonisë, Ministria e financave.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë. (2020). *Buxheti 2021, Një vështrim për qytetarët*. Tiranë: Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar,.
- Mirkovic, M. (2020). *Montenegro economy briefing: Montenegrin economy in 2020*. China - CEE Institute.
- Mohammed Alqadi, S. I. (2019). *Government spending and Economic Growth: Contemporary Literature Review*. Malaysia: Journal of Global economic.
- Nora Hasani, S. D. (2020). *A Foreign Investor's Guide to Kosovo*. Pristina: Konrad-Adenauer Foundation in the Republic of Kosovo.
- OEAK. (2020). *Analizë tematike, Ndikimi ekonomik i covid-19 në Kosovë*. Prishtinë: Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë.
- OECD. (2021). *Bosnia and Herzegovina profile*. Competitiveness in south east europe.
- Panth, P. (2020). *Economic Development: Definition, Scope and Measurement*. India: Department of Economics, Osmania University.
- Roaa Alrazyeg, A. A. (2019). *Government expenditure and economic growth in Saudi Arabia*. Sama working paper.
- S. V Seshaiyah, T. K. (2018). *General Government Expenditure and Economic Growth in India: 1980-81 to 2015-16*. India: Scientific Research Publishing.

Sheilla Nyasha, N. M. (2019). *The impact of public expenditure on economic growth: A review of international literature*. South Africa: Folia Oeconomica Stetinensia.

Stine Klapper, D. H. (2020). *Sfidat e zhvillimit ekonomik në Shqipëri*. Tiranë: Friedrich Ebert Stiftung.

USAID. (2020). *Strategjia saradnje na razvoju zemlje*.

VCG. (2020). *Program ekonomskih reformi za crnu goru 2020-2022. Godina*. Podgorica : Vlada crne gore.

WB. (2019). *Sowing the seeds of a sustainable future-Republic of North Macedonia: Public finance review*. World Bank Group.

WBG. (2021). *Raporti i rregullt ekonomik për ballkanin perëndimor Shqipëria, Rimëkëmbje e gjelbër*. World Bank Group.

WBO. (2020). *RRrE për Ballkanin Perëndimor- Shqipëria*. World Bank Organization.